

**RAPORT PARAPRAK
VLERESIM I NDIKIMIT NE MJEDIS**



SHTOJCA II: PIKA 3, Ë :

**INSTALIME PËR PRODHIMIN E ENERGJISË HIDROELERIKE
PER HIDROCENTRALIN KAPARJEL, NE PELLGUN UJEM-
BLEDHES, PERROI I GUGASHIT **

**(NDERTIMIN E BURIMIT TE RIGJENERUES TE ENERGJISE
NGA HIDROCENTRALI "KAPARJEL")**

PELLGUN UJEMBLEDHES, PERROI I GUGASHIT

ISH KOMUNA PICAR

RRETHI GJIROKASTER

QARKU GJIROKASTER

**RAPORT PARAPRAK
VLERËSIM NDIKIMIT NË MJEDIS**

Ky Raport paraparak i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis u pergatit per projektin:

*Rikonstruksion-Operim-Transferim te HEC Kaparjel, ne pellgun ujembledhes, Perroi i
Gugashit Vendodhja: Ish Komuna Picar, Gjirokaster –Qarku Gjirokaster*

Shoqeria Investitore/Ndertuese: “ABV KONSTRUKSION”sh.p.k

Revizionuar:

Rev/2
Prill 2016

Aprovuar:

Ekspert Mjedisori Hamdi Hoti
LN-7034/11-2013 (Data e leshimit 15/11/2013)

Vleresues i Ndikimit ne Mjedis dhe Auditues Mjedisor

Nr. 5099 prot, Nr. Identifikues. 160, date 08.07.2013

Bashkeautor :

Hamdi Hoti

Ing Mjedisori Fatjona Levani



**RAPORT PARAPRAK
VLERËSIM NDIKIMIT NË MJEDIS**

Tabela e raportit paraprake te VNM:

1.	TE DHENA TE PERGJITHSHME	5
1.1	Te pergjithshme per HEC Kaparjel.....	7
1.2	Klasifikimi i projektit per proceduren e VNM	9
1.3	Pershkrim i shkurter per kapitujt e Raportin paraprak te VNM-se, ku përfshihen:	10
2.	NJË PËRSHKRIM I SHKURTËR I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHET TË ZBATOHET PROJEKTI, SHOQËRUAR DHE ME IMAZHE.....	12
2.1.	Hyrje	12
2.2.	Vlerat ekologjike (flora dhe fauna).....	12
3.	Informacioni për praninë e burimeve ujore në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të saj.	16
3.1.	Kushtet Klimatike	16
3.2.	Burimet ujore ne rajon	19
4.	IDENTIFIKIM I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS TË PROJEKTIT, PËRFSHIRË NDIKIMET NË BIODIVERSITET, UJË, TOKË DHE AJËR, PËRSHKRIM I SHKURTËR PËR SHKARKIMET E MUNDSHME NË MJEDIS, TË TILLA SI: UJËRA TË NDOTURA, GAZE DHE PLUHUR, ZHURMË, VIBRIME, SI DHE PËR PRODHIMIN E MBETJEVE SI DHE INFORMACIONI PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE TË IDENTIFIKUARA,	21
4.1.	Vleresim i impakteve kryesore ne mjedis	21
4.2.	Masa lehtesuese mjedisore	33
5.	TË DHËNA PËR SHTRIRJEN E MUNDSHME HAPËSINORE TË NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDIS QË NËNKUPTON DISTANCËN FIZIKE NGA VENDNDODHJA E PROJEKTIT DHE VLERAT E NDIKUARA QË PËRFSHIHEN NË TË.....	43
5.1.	Distancën fizike nga vendndodhja e projektit dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të.	45
6.	MUNDËSINË E REHABILITIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSINË E KTHIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR TË SIPËRFAQES NË GJENDJEN E MËPARSHME, PËRFSHI EDHE KTHIMIN E TOKËS BUJQËSORE (NË RAST SE PËRDORIMI EKZISTUES ËSHTË I TILLË) DHE KOSTOT FINANCIARE TË PËRAFËRTA PËR REHABILITIMIN;.....	49
6.1.	Rehabilitimi i mjedisit te ndikuar nga ndertimi i Hec ne rrjedhje e pellgut ujembledhes Kaparjel.....	49
6.2.	Investimet e parashikuara	51

**RAPORT PARAPRAK
VLERËSIM NDIKIMIT NË MJEDIS**

7. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS;.....	53
7.1. Vleresimi i ndikimit ne mjedis dhe masat lehtesuese	53
7.2. Kriteret per monitorimin e projektit “Rikonstruksion-Operim-Transferim te HEC – Kaparjel, Pellgu Ujembledhes Kaparjel”	62
8. NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR (NËSE PROJEKTI KA NATYRË TË TILLË).	67
9. CERTIFIKATËN DHE LICENCËN PËRKATËSE TË QKL-SË, TË SPECIALISTIT QË KA HARTUAR RAPORTIN PARAPRAK TË VNM-SË.....	69

**RAPORT PARAPRAK
VLERËSIM NDIKIMIT NË MJEDIS**

1. TE DHENA TE PERGJITHSHME

Ky raport paraprake VNM se bashku me kerkesen dhe dokumentacionit shoqërues nga ana e zhvilluesit, do te paraqiten në Ministri te Mjedisit dhe AKM per miratim te kerkeses per Rikonstruksion te H/C Kaparjel-Gjirokaster i cili ka marr miratim paraprake nga MEI si pjese e procedurave te kerkuara per miratim nga Agjensia Kombetare e Mjedisit. Ministria e Mjedisit përcjellja e dokumentacionit në AKM per marrjen e Vendimit nga AKM per nenshtrimin te procedurave paraprake te VNM per projektin: Rikonstruksion-Operim-Transferim te HEC-Kaparjel, ne rrjedhjen e Perroit Gugashit me vendodhje ne rrjedhje e Perroit Gugashit. i cili prek territorin e Ish Komuna Picar, Rrethi Gjirokaster, Qarku Gjirokaster.

Zhvilluesi dhe subjekti ndertues ABV-KONSTRUKSION.Sh.p.k, që synon të zbatojë segment te Hidrocentralit qe do te ri-ndertohen sipas marreveshjes se miratimit nga Ministria e Energjitikes dhe Industrise te formes per ri-ndertimin e Hidrocentralin Kaparjel, ne pellgun ujembledhes, Perroi i Gugashit, qe do i jepet Shoqërisë nga MEI pas pajisje me Vendim AKM, i cili sipas studimit te realizuar nga grupi i projektuesve te nenkontraktuar nga subjekti e kane emeruar Hidrocentrali Kaparjel (Mikro Hidrocentral me kapacitet ekzistues 125kW).

Shoqeria “ABV - KOSTRUKSION”sh.p.k, kerkon te dorezoj kete **RAPORT PARAPRAKE TE VNM –SE** per AKM per procedure te kerkuar per zhvillimin e projektit :

*“Rikonstruksion-Operim-Transferim te HEC-Kaparjel ne rrjedhjen e Perroit Gugashit
Vendodhja: Ish Komuna Picar, Bashkia Gjirokaster –Qarku Gjirokaster*

Karakteristikat teknike te Hidrocentralit Kaparjel qe do te ndertohet ne rrjedhjen e Perroit Gugashit , operoj dhe transferoj ne kete zone te rrethit te Gjirokaster-Qarku Gjirokaster.

Karakteristikat	Te dhenat
Kuota e vepres se marrjes(kreu i diges)	495.0 m (m.n.d)
Kuota e godines se centralit	450.0 m (m.n.d)
Fuqia e instaluar	200 kW (0.2MW)

Objektivi i projektit të propozuar “Rikonstruksion-Operim-Transferim te HEC-Kaparjel ne rrjedhjen e Perroit Gugashit” paraqitet prane institucionit tuaj per tu pajisur me konfirmim nga AKM si procedure e kerkuar eshte edhe pergatitja e raportit te Vleresim Ndikimi ne Mjedis duke iu referuar Vendimit Nr. 822, datë 7.10.2015 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni” si dhe Ligji Nr.111/2012 “Per menaxhimin e integruar te burimeve ujore” i azhurnuar, si dhe ne kuader te Strategjise Sektoriale e Energjise 2006-2020 dhe Strategjia e energjise 2007 - 2013, zhvillimit te politikave afatgjate per rritjen e kapaciteteve te shfrytezimit te burimeve te rinovueshme të energjisë. Ne nje prizem me te gjere ky projekt ne menyre indirekte do te ndikoj ne plotesimin deri diku te nevojave energjetike per energji elektrike pra duke përdorur energji të ripërtëritshme qe vleresohet sot si “energji e paster”. Projekti ne menyre indirekte gjithashtu ka për qëllim zvogëlimin e emetimeve të gazit me efekt sere (CO2) duke shmangur pengesat për zhvillimin e energjisë së përtëritshme.

**RAPORT PARAPRAK
VLERËSIM NDIKIMIT NË MJEDIS**

Ne perputhje me kerkesat e percaktuar ne si dhe ne kuader te Strategjise Sektoriale e Energjise 2006-2020 dhe Strategjia e energjise 2007 - 2013, zhvillimit te politikave afatgjate per rritjen e kapaciteteve te shfrytezimit te burimeve te rinovueshme të energjisë. Ne nje prizem me te gjere ky projekt ne menyre indirekte do te ndikoj ne plotesimin deri diku te nevojave energjetike per energji elektrike pra duke përdorur energji të ripërtëritshme qe vleresohet sot si “energji e paster”. Projekti ne menyre indirekte gjithashtu ka për qëllim zvogëlimin e emetimeve të gazit me efekt sere (CO₂) duke shmangur pengesat për zhvillimin e energjisë së përtëritshme.


Duke synuar zhvillimin strategjik e ketyre rezervave ujore per prodhim te energjisë së përtëritshme (kryesisht MHPP) Projekti do ta rrisë pjesën e burimeve të ripërtëritshme në strukturën e prodhimit të energjisë elektrike ne rang rajonal per Republikën e Shqipërisë. Zhvillimi i projekteve per prodhimin e energjisë së rinovueshme është i vlefshëm që nga: (i) kostot e prodhimit në përgjithësi janë konkurruese me forma të tjera të prodhimit të energjisë elektrike, (ii) se do të rrisë diversifikimin e furnizimit me energji elektrike dhe sigurinë e energjisë, (iii) se do të kontribuojë në reduktimin e emisionet dhe ndotja.

Shoqeria “ABV KONSTRUKSION“sh.p.k do të ushtroj veprimtarine e saj te shfrytezimit te rezervave ujore per prodhim te energjise elektrike gjatë gjithë periudhës së marrjes me miratim per rreth 25-35 vjet si periudhe efektive. Buxheti i propozuar i projektit është rreth 27 592 074 leke, te cilet do te sigurohen si investime private psh. miratimet me tender te mbyllur kane te drejt te disponojne, te kryejne transaksione me pale te trete dhe te shese pjese te energjise elektrike te prodhuar nga ky hidrocentral duke perfshire edhe transaksionet qe ka te beje me prodhimin e energjise se rinovueshme dhe vecanerisht ne lidhje me Mekanizmat e Zhvillimit te Pastertise (Clean Development Mechanism) ne kuadrin e Protokollit te Kyoto-s. Pjesa tjetër do të kontribuohet nga burimet finaciare te vete shoqerise investitore, perfitim ky i mundesuar nga prodhimi dhe shitja e energjise elektrike ndaj konsumatorit lokal.

Për nevojat e shoqerise“ABV KONSTRUKSION”sh.p.k është e domosdoshem qe aktiviteti “Rikonstruksion-Operim-Transferim te Hidrocentralit Kaparjel ne rrjedhjen e Perroit Gugashit” te pajiset me Vendim AKM pasi eshte miratuar ne parim nga MEI, procedure e kerkuar per kete aktivitet ekzistues qe do te zhvillohet ne kete zone te Ish Komunes Picar, Bashkia Gjirokaster, Rrethi Gjirokaster, ku specifikisht treguesit energjitk te hidrocentralitit jane:

Objekti	Pershkrimi
Q _{lllog}	0.6 m ³ /s
H _{neto}	40.0 m
Q _{ekol}	5-10%

RAPORT PARAPRAK
VLERËSIM NDIKIMIT NË MJEDIS



Harta nr. 1: Topografia e zones se gjurmes te H/C Kaparjel

1.1 Te pergjithshme per HEC Kaparjel

Rikonstruksioni: Eshte ndertuar ne vitin 1969, per furnizimin me energji elektrike te fshatrave Kaparjel e Zhulat. Ky hidrocentral eshte i tipit me derivacion dhe shfrytëzon ujerat e perroit qe kalon prane fshatit Kaparjel. Gjendet ne fshatin Kaparjel, rrethi Gjirokastrer.

Parametrat ekzistues perpara shkaterrimit te HEC-it kane qene: $Q_{llog}=0,40$ m³/sek; Hneto = 40m; N= 125 kW. Ne te, ka qene vendosur nje h/a prodhim kinez, me hidroturbine Francis tip HL-129-WJ-420. Hec-i eshte i lidhur me sistemin me linjen ekzistuese TM 10 kV me gjatesi 27 km. Ky HEC punon gjate gjithë vitit pasi ujerat qe shfrytëzon nuk perdoren per vaditje nga bujqesia. Parametrat e parashikuara per HEC-in e rikonstruktuar jane: $Q_{llog}=0.6$ m³/sek; Hneto = 40 m; Ngj =200kW.

Eshte parashikuar qe te instalohet nje h/a Francis, me gjenerator sinkron dhe fuqi prej 200 kW. Rikonstruksioni parashikon punime permiresimi ne krejt vepren hidroteknike, perفشire dhe ndertesën dhe kushtet higjieno - sanitare.

Ne perfundim, rikonstruksioni eshte zbatim i studimit te fuqise se munguar te HEC – it; duke nderhyre ne te gjitha nenveprat e tij, per ta pershtatur me parametrat e studimit. Duke qenese do te ruhen te gjitha kuotat ekzistuese, ne zbatim sherbejne projektet ekzistuese me permiresime. Ne raste te domosdoshme, do te ribehen matje topografike, si dhe shtesa ne projekte.

Gjate rikonstruksionit jane parashikuar punime ne gjithë vepren hidroteknike, ne ndertese, rrugen hyrese ne hec dhe sistemime.

**RAPORT PARAPRAK
VLERËSIM NDIKIMIT NË MJEDIS**

Vepra e marrjes: Rikonstruktohet ne pershtajtje me prurjen e projektuar duke zgjeruar seksionin e hyrjes se ujit dhe perforcuar strukturat b/a e ankorimet.

Ne cdo rast, eshte parashikuar minimalisht 5 deri 10%, prurje e lire e burimit apo lumit; per te ruajtur ekosistemin, ne kuotat e punes te hec-it.

Kanali i derivacionit: Duke qene se ruhen kuotat ekzistuese, rikonstrukcioni parashikon zgjerimin e seksionit, ne perputhje me prurjen e re te projektuar.

Do te kryhen punime pastrimi, mur guri, suva e shtresa betoni, sistemime te shpateve, mbi e nen kalime ne zona te aksidentuara; ne cdo rast, duke patur ne konsiderate ruajtjen dhe permiresimin e mikro-ekosistemit, kudo ku kalon kanali.

Zgjerimi, sistemimi dhe permiresimet, ne kanalim e derivacionit, permiresojne ndjeshem sasine e ujitjes; ne te gjitha rastet, kur vepra kryen sherbime te dyfishta, apo eshte ndertuar ne sherbim te bujqesise.

Aty ku eshte e nevojshme, do te kryhen edhe pyllezime, per mbrojtjen e shpateve nga rreshqitjet. Po ashtu, do te behen prita, ne kalimet e perrenjve, apo vijave te ujit.

Ne mjaft seksione te kanalit, me rrezik mbushje nga dherat e siperme, kanali do te jete i mbuluar.

Pikat e derdhjes se prurjeve te teperta, jane zgjedhur ne vende, qe nuk demtojne terrenin, si dhe tokat bujqesore.

Kanalet qe sherbejne edhe per ujitje, do te kene shkarkime te komanduara, ne perputhje me kerkesat e pronareve te tokave; si per vendndodhjen, ashtu edhe per sasine e ujit, e cila nuk do te kete kufizime.

Baseni i presionit: Do te kete zgjerim dhe rritje vellimi ujembajtes, ne perputhje me prurjen llogaritese. Do te kryhen punime ndertimore, si mur guri me llac cemento, betonime e shtresa betoni, suva, vendosje porta e zgare metalike. Te gjitha punimet do te kryhen me dore, per shkak te terrenit ku gjenden. Kerkese themelore teknike eshte eliminimi i rrjedhjeve eventuale ne basenin e presionit. Kerkese kjo, ne perputhje edhe me ruajtjen e mjedisit ku eshte ndertuar. Ne cdo rast do te kete punime sistemimi, perforcime te domosdoshme, per te patur siguri te plote gjate punes se hec-it.

Tubacioni i presionit: Pergjithesisht, eshte vendosur mbi terren dhe mbeshtetet ne jastek. Ne pikat e kthesave, ankorohet me bllokazhe. Mjedisi perreth sistemohet, kerkese kjo edhe e kushteve te shfrytezimit. Per ta mbrojtur nga shkaterrimi, per efekt te zgjatimit e shkurtimit, nga ndryshimi temperatures se mjedisit; ne tubacion vendosen pajisje mbrojtese (compensatore). Tubacioni do te vishet me shtresa izoluese, per ta mbrojtur nga veprimi i agjenteve atmosferike (ndryshkja).

Ndertesa e hec-it: Ne cdo rast do te ristrukturohet, ne perputhje me kerkesat e makinerise qe do vendoset; si dhe ne drejtim te plotesimit te kerkesave te punes, sigurimit teknik dhe higjenu – sanitar. Keshtu, do te kete hapësire te nevojshme perreth makinerise, per kryerjen normale te sherbimeve dhe mirembajtjes. Do te kete mjedis te vecante per personelin, WC, depo. Panelet elektrik, do te jene ne mjedise te vecante e te mbrojtur. Mjedisi perreth, do te jete i sistemuar dhe i rrethuar.

Rruga per ne hec: Ne te gjitha rastet, eshte parashikuar, qe mjetet e transportit, te mund te afrohen deri tek dera e hec-it. Kjo do te realizohet edhe ne bashkepunimin me pronaret e tokave, ku kalon apo do te kaloje rruga; si dhe ne perputhje me aktet ligjore ne fuqi. Lloji

**RAPORT PARAPRAK
VLERËSIM NDIKIMIT NË MJEDIS**

punimeve dhe makinerive, qe do perdoren gjate rikonstruksionit. Gjate rikonstruksionit, do te kryhen punime ndertimore dhe elektromontime. Ne punimet ndertimore perfshihen: germime dheu e ne struktura shkembore, mure guri me llac cemento, betonime e shtresa betoni, suva e bojatisje. Keto punime, do te realizohen kryesisht me dore, per shkak te terrenit te vendndodhjes se hec-ve. Ne rastet, kur eshte mundesia e perdorimit te mekanizmave, do te perdoren mjete germuese e trasportuese te motorizuara. Per shkak te kerkesave dhe kushteve specifike te hec-ve, eshte perjashtuar mundesia e perdorimit masiv te lendeve plasese. Ne ndonje rast te vecante, mund te perdoret lende plasese ne perputhje me kushtet e mbrojtjes ne pune, sigurimit teknik dhe te akteve ligjore. Ne cdo rast te tille, do te kete bashkepunim me pushtetin lokal dhe eventualisht edhe me banoret prane objektit.

Mbrojtja ne pune: Punimet e rikonstruksionit, ndertimore dhe elektromekanike, do te kryhen ne perputhje me normat e sigurimit teknik e te mbrojtjes ne pune, te percaktuara me aktet ligjore te Republikes se Shqiperise. Keshtu, transportet, ngarkim-shkarkimet, levizjet e ngarkesave te renda etj; do te realizohen me mjetet perkatese, si makina veteshkarkuese, autovinca e elektrovinca, parango, mjete te mekanizuara germimi e levizje dheu, elektro-teleferik etj. Makinaria qe do te vendoset, do te jete krejtesisht automatike dhe ne drejtim te sigurimit teknik e mbrojtjes ne pune; do te jete ne perputhje me normat e vendit dhe te Komunitetit European. Keshtu, punonjesi i shfrytezimit do te jete thjesht nje manovrator e mbikqyres; ndersa sherbimet e riparimet, do te kryhen nga specialistet te kualifikuar dhe autorizuar.

Elementet e centralit: Vepra e marrjes vendoset ne kuoten + 495 m. Kanali i derivacionit nga kuota+495 m zbritet deri ne kuoten +491 m . Gjatesia e kanali eshte 447m me nje pjerresi I = 3 per/mije. Baseni i presionit, vendoset ne kuoten + 491m. Godina e centralit, vendoset ne kuoten +450 m.

1.2 Klasifikimi i projektit per proceduren e VNM

Projekti ne vleresim (Rikonstruksion-Operim-Transferim te HEC-Kaparjel, ne rrjedhjen e Perroit Gugashit), i cili eshte subjekt i kerkesave te nenit 8 te ligjit nr. 10 440, date 7.7.2011 "Per vleresimin e ndikimit ne mjedis", **SHTOJCA II:Projektet qe i nenshtrohen procedures paraprake te vleresimit te ndikimit ne mjedis**, **Pika 3. Industria e energjise, nenpika e) Instalime per prodhimin e energjise hidroelektrike;** kerkohet qe ne fazat fillestare te planifikimit te projektit (projektdesë), kur te paraqet pranë AKM-së per miratim, si dhe dokumentacioni i kerkuar sipas ligjit nr. 10 081, date 23.2.2009 "Per licencat, autorizimet dhe lejet ne Republikën e Shqiperisë", dhe dokumentacionin perkatës, i cili do te permbaj:

Përshkrimin e projektit të propozuar, të cilin e kemi përgatitur dhe bashkeemëruar "Dokumentacioni Tjeter" te gjitha dokumentat me nenzero perkatese te perfshira ne ku perfshihen keto informacione dhe te dhena teknike si:

- a) përshkrimi i qëllimit të projektit të propozuar (Relacioni teknik);
- b) planimetria e vendndodhjes së projektit ku të pasqyrohen në hartë topografike sipërfaqja e tokës së kërkuar, kufijtë e sipërfaqes së tokës së kërkuar, fotografi dhe të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes së tokës që do të përdoret përkohësisht apo përherë nga projekti gjatë fazës së Rikonstruksionit apo funksionimit të veprimtarisë së projektit (Projekt zbatimi e studimit te ndertimit te HEC Kaparjel+ relacion teknik);

**RAPORT PARAPRAK
VLERËSIM NDIKIMIT NË MJEDIS**

c) informacioni për qendrat e banuara në zonën ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar me fotografi dhe të dhëna për distancën nga vendi ku propozohet projekti e për njësinë e qeverisjes vendore (bashkia) që administron territorin ku propozohet projekti (Genplan i rajonit për vendbanimet e zones si dhe distancat prej tyre;

ç) skicat dhe planimetritë e objekteve të projektit dhe strukturave të projektit (Projekti teknik);

d) përshkrimi i proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese/përpunuese, sasitë e lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit (Preventive);

dh) informacioni për infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacion për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja (PËRSHKRIMI I PROJEKTIT);

e) programi për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar të funksionimit të projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe, sipas rastit, edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes pas mbarimit të funksionimit të projektit (Plan rehabilitimi);

ë) mënyrat dhe metodat që do të përdoren për Rikonstrukcionin e objekteve të projektit (Plan rehabilitimi+projekt teknik);

f) lëndët e para që do të përdoren për Rikonstrukcionin dhe mënyra e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji);

g) informacioni për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zonës së projektit ((raporti i VNM-se ne vleresim);

gj) informacioni për alternativat e marra në konsideratë për sa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret (relacioni teknik);

h) të dhëna për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasitë e ujit të nevojshëm, energjisë, lëndëve djegëse dhe mënyrën e sigurimit të tyre (relacioni teknik);

i) aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si: ndërtimi i kampeve apo rezidencave etj (relacioni teknik);

j) informacioni për lejet dhe licencat e nevojshme për projektin, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin/licencimin e projektit (Kërkesa e subjektit +dokumentacioni teknik+kontrata).

1.3 Përshkrim i shkurtër për kapitujt e Raportin paraprak të VNM-se, ku përfshihen:

Ky raport paraprak i VNM është përgatitur në përputhje me Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 686, datë 29.07.2015, "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis" ku specifikisht Kreu I, (Zhvillimi i procedurës paraprake të vlerësimit të ndikimit në mjedis) si me poshte sqaruar:

Fazat e procedurës paraprake të VNM-së: Procedura paraprake e vlerësimit të ndikimit në mjedis (VND) zbatohet për projektet që janë subjekt i kërkesave të nenit 8 të ligjit nr. 10 440, datë 7.7.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", dhe kalon në këto faza të njëpasnjëshme:

a) Paraqitja e kërkesës dhe dokumentacionit shoqëruar nga zhvilluesi në MM dhe përcjellja e tyre nga MM-ja në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM);

b) Konsultimi i AKM-së me institucionet e tjera dhe publikimi i kërkesës;

**RAPORT PARAPRAK
VLERËSIM NDIKIMIT NË MJEDIS**

c) Marrja e vendimit nga AKM-ja, njoftimi i Ministrisë së Mjedisit, institucioneve të konsultuara, si dhe publikimi i vendimit në Regjistrin Kombëtar të Lejeve dhe Licencave.

Raportin paraprak te VNM-se, ku përfshihen:

Kapitulli I: Te dhena te pergjithshme per projektin

Kapitulli 2: një përshkrim i shkurtër i mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar dhe me imazhe;

Kapitulli 3: informacioni për praninë e burimeve ujore në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të saj;

Kapitulli 4: një identifikim i ndikimeve të mundshme negative në mjedis të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër; një përshkrim i shkurtër për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurmë, vibrime, si dhe për prodhimin e mbetjeve; informacioni për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuara;

Kapitulli 5: të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të;

Kapitulli 6: mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme, përfshi edhe kthimin e tokës bujqësore (në rast se përdorimi ekzistues është i tillë) dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin;

Kapitulli 7: masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis;

Kapitulli 8: ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar (nëse projekti ka natyrë të tillë);

Kapitulli 9: certifikatën dhe licencën përkatëse të QKL-së, të specialistit që ka hartuar raportin paraprak të VNM-së.

**RAPORT PARAPRAK
VLERËSIM NDIKIMIT NË MJEDIS**

2. NJË PËRSHKRIM I SHKURTËR I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHET TË ZBATOHET PROJEKTI, SHOQËRUAR DHE ME IMAZHE

2.1. Hyrje

Nyja Hidroenergjitike e emertuar hidrocentrali Kaparjel, Gjirokaster, ndodhet ne fshatin Kaparjel- ne degen e perroit Gugashit, i cili eshte dege i majte e lumit Kardhiqit.

Rikonstruksioni parashikon punime permiresimi ne krejt vepren hidroteknike, perfshire dhe ndertesën dhe kushtet higjieno – sanitare. Ne perfundim, rikonstruksioni eshte zbatim i studimit te fuqise se munguar te HEC – it; duke nderhyre ne te gjitha nenveprat e tij, per ta pershtatur me parametrat e studimit. Duke qenese do te ruhen te gjitha kuotat ekzistuese, ne zbatim sherbejne projektet ekzistuese me permiresime. Ne raste te domosdoshme, do te ribehen matje topografike, si dhe shtesa ne projekte

2.2. Vlerat ekologjike (flora dhe fauna)

Për sa u përket vlerave ekologjike:

Pellgu ujembledhes, kryesisht ndertohtet nga shkembinj terrigjene (flishe), keto te kufizuara ne zonen malore ku fillon perroi. Zona dallohet per nje copetim te theksuar horizontal, e cila eshte favorizuar nga perhapja e formacioneve terrigjene, nga rreshjet e shumta dhe varferia e mbuleses bimore. Si rezultat kemi siperfaqje te eroduara ku jane krijuar vatra erozive.

Kushtet klimatike, lartesia e relievit, mbulesa bimore dhe perberja litologjike kane percaktuar zhvillimin e tokave te kafenjta, te hirta kafe etj.

Pellgu ka bimesi rreth 57% te siperfaqjes se tij, ku pjesa me e madhe mbulohet nga shkurret e tipit mesdhetar me gjelberim te perhershem. Ne pjesen e siperme zhvillohet dushku ne lartesine mbi 700m(mnd).

Flora: Ne pergjithesi lugina e perroit te Gugashit ne pjesen e siperme te kurores perbehet nga shkure, etj. Megjithese duhet theksuar se zona eshte e varfer me bimesi, ne krahun verior te perlgut te ketij perroi. Krahas drureve te ahut ne kete zone gjendet edhe pisha e zeze (Pinus nigra), bredhi i bardhe, pyjet e rrobullit (Pinus Helderichi) dhe arnenit (Pinus Peuce)

Fauna: Pe sa i takon faunes ne kete zone gjenden gjitare si ujku, dhelpra, lepuri, kunadhja, ketri etj. Ne zona te vecanta mund te takohet edhe dhia e eger, rrequebulli, qlbsi, kunadhja, lepur I eger.

Shpendet karakteristike te zones jane sterqoka e malit (Pyrrhocorax graculus), orli me mjeker (Gypateus barbatus) lauresha me brire (Eremphila alpestris) zvarritesi krahkuq (Tichodroma

**RAPORT PARAPRAK
VLERËSIM NDIKIMIT NË MJEDIS**

mararia), drenja e malit (*Arthus spinoletta*). Perhapje te madhe ka edhe thelleza e malit (*Alectoris graeca*)shqiponja e malit (*Aquila Crysaetus*) gjeli I eger. (*Tetrao Uorgallus*) pula e pyllit (*Tetrastes bonosia*)

Zona me status te vecante: Shtrirja e ketij projekti nuk prek zonat e mbrojtura apo monumentet natyrore si dhe ndodhet larg zonave buferike te tyre. Edhe pse ndodhet prane Lugines se Kardhiqit (Gjirokastrë). Bën pjesë në Krahinën Malore jugore, në mes të Krahinës së Kurveleshit e Malit të Gjerë. Përfaqëson një luginë grabenore, e përbërë kryesisht nga formime flishore. Ka reliev shumë të çrregullt, plot me rrëshqitje, kanione e karste e të dominuar kryesisht nga gëlqeroret, ndonëse në pjesën e poshtme lugina hyn në flish. Dallohet për shpate me pjerrësi të madhe (31-45) e, në të dy anët e tij shfaqen disa nivele terracash. Monitorimi i kësaj lugine merr rëndësi edhe për faktin se aty është projektuar të kalojë rruga kombëtare, Gjirokastrë-Delvinë, e cila natyrisht do të ketë ndikimin e saj mbi habitatet dhe botën e gjallë të kësaj zone. Aktualisht kjo zonë gëzon statusin Zonë Strikt të Mbrojtur (Kategoria I -VKM nr.102,datë 15.01.1996, 1800 ha)). Në tërësi, në nivelet e poshtme, bimësia dominohej nga shqemja; por e përzier dhe me elemente të makies mesdhetare, kurse në nivelet e mesme shtoheshin shoqërimet me dushkaja (*Quercus sp. div*), thuajse të degraduara, dhe shkozishte (*Carpinus orientalis*) dhe mëllezer (*Ostrya carpinifolia*) mbi to. Në lartësitë më të mëdha, pylli gjethgjerë përzihej me bredha (*Abies borissi-regis*) e halorë të tjerë, momentalisht jashtë optikës sonë. Shoqërimet me shqeme (*Cotinetum coggygria*) ndodhen në nivelet e poshtme dhe të mesme, shpesh edhe mbi shkozishte. Ato janë shumë të qarta, ndonëse normalisht ato kanë prejardhje dytësore. Përfaqësojnë shkorreta të dendura, të shoqëruara shpesh, në katin shkurror edhe nga fshikartha-*Colutea arborescens*, dëllinja-*Juniperus oxycedrus*, driza-*Paliurus spina christi*, xinë -*Pistacia terebinthus*, pralli -*Quercus coccifera*, krifsha- *Phillyrea angustifolia*, mareja-*Arbutus unedo*, mënishtet -*Cistus villosa* dhe *C salviaefolius*, gorrica- *Pyrus amygdaliformis*, xana- *Spartium junceum*, kulpra- *Clematis vitalba*, bezgë -*Phlomis fruticosa*, lofata- *Cercis siliquastrum*, bushi- *Buxus sempervirens*, si dhe frashëri i bardhë -*Fraxinus orientalis*, ilqja- *Quercus ilex*. Ndërkohë edhe bimësia barishtore është e pasur, por jo shumë e dendur për arsye të ndikimit të katit shkurror. Nga to përmendim: *Acanthus spinosa*, *Aegilops triuncialis*, *Helianthemum nummularium*, *Trifolium angustifolium*, *Bupleurum flavicans*, *Eryngium campestre*, *Cynosurus echinatus*, *Cruciata laevipes*, *Dorycnium pentaphyllum*, *Helianthemum nummularium*, *Sanguisorba minor*, *Teucrium pollium*. në vende më të mbrojtura e paksa më të freskëta ky tip formacioni përzihej me grumbuj ilqeje (*Quercus ilex*) e frashëri të bardhë (*Fraxinus ornus*), kurse në vende më të ekspozuara, shulla, vërehen edhe copëza të makies apo të friganave (*Arbutus unedo*, *Erica verticillata* etj). Në habitatet gurishtore, si dhe në shkëmbinj u vunë re ramonda e Serbisë (*Ramonda serbica* -VU-A1b), lulebasamin haplofil (*Hypëricum haplophylloides* -LR-Cd-Endemike), dafina (*Laurus nobilis* EN-A1b-) por edhe bimë të tjera me vlerë si ajdës -(*Laburnum alpinum*), etj. Në këto mjedise hasen gjithashtu edhe shumë bimë mjekësore, por që sidoqoftë janë të rrezikuara për vendin: çaji i ma lit (*Sideritis raeseri* – EN-A1c), bliri (*Tilia platyphyllos* – CR-A1c), rigoni (*Origanum vulgare* (EN-A1b), etj. Në pjesën jugore të grykës mbi Prongji, pra në nivelet më të larta të saj, terreni bëhet mjaft i pjerrët dhe bimësia përfaqësohet nga pyje fletore përzier me halore, kryesisht bredh (*Abies borissi-regis*). Nuk duam të zgjatemi në përshkrimin e florës së këtij pylli, pasi ajo ishte e ngjashme me atë të pyjeve të tjerë të tillë në këtë zonë, si psh. në Sotirë të Gjirokastrës. Duam vetëm të theksojmë faktin se në grykëzat e këtij pylli, në terrene të pjerrta të tij, s' idomos aty ku ai dominohej nga mëllezra

RAPORT PARAPRAK
VLERËSIM NDIKIMIT NË MJEDIS

(*Ostrya carpinifolia*) hasen grumbuj jo të vegjël të gështenjës së kalit (*Aesculus hippocastanum* – CR-A1a), bimë mjaft e rrallë dhe e kërcënuar në vendin tonë. Gjithashtu në këtë zonë hasen, veçanërisht në terrene jo gëlqerore, edhe grumbuj jo të mëdhenj me gështenjë (*Castanea sativa*), me shkozë (*Carpinus orientalis*), si zëvendësues i dushkajave të degraduara, me shelgje (*Salix sp.div*) e rrepe (*Platanus orientalis*). Në tërësi kjo zonë ka vlera edhe për praninë atje të një sërë bimësh të tjera, me areal të kufizuar, si psh ato balkanike: *Acanthus balcanicus*, *Chamacytiscus jankae*, *Bupleurum flavicans*, *Stachelina uniflosculosa*, *Hypëricum rumeliacum*, *Ramonda serbica*, etj.

Zona është përgjithësisht e hapur dhe mjaft e gjerë, por nga këndvështrimi botanik, pra për vlerat e florës e b imësisë, rëndësi më të madhe paraqesin grykat, sidomos ato të niveleve të mesme e të larta. Pjesa tjetër e kësaj zone, sidomos ajo pranë rrugës dhe fshatrave, është mjaft e degraduar dhe e urbanizuar e nuk paraqet ndonjë rëndësi të veçantë. Kalimi i rrugës kombëtare për në Delvinë do e trondisë sadopak këtë biodiversitet, sidomos atë përgjatë grykave.



Harta nr. 2: Zonat me status ne rajon

**RAPORT PARAPRAK
VLERËSIM NDIKIMIT NË MJEDIS**

Tabela e fotove te zones



RAPORT PARAPRAK
VLERËSIM NDIKIMIT NË MJEDIS

3. Informacioni për praninë e burimeve ujore në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të saj.

3.1. Kushtet Klimatike

Duke u mbeshtetur ne ndarjen klimatike te vendit tone, zona ne studim, pjesa e sipërme e tij është ne nenzonen jugore malore, ndersa pjesa e poshtme ndodhet ne nenzonen Mesdhetare Kodrinore Qendrore. Karakteristikat kryesore te ketyre nenzonave klimatike jane dimra relativisht te forte dhe te laget dhe vera te nxehte dhe pothuajse te thata. Reshjet bien kryesisht ne forme shiu, ndersa renia e debores gjate muajve te dimrit nuk është dukuri e zakonshme.

Pellgu ujembledhes i perroit te Gugashit shtrihet ne zonen klimatike mesdhetare malore juglindore dhe karakterizohet nga dimra te ftohte dhe verera te fresketa. Temperatura mesatare shumevjecare e ajrit është 7,4°C. Temperatura e muajit janar, muajit me te ftohte te vitit, është -2,0°C Temperatura me e ulet ka arritur deri ne -23,2°C. Temperatura e muajit mete ngrohte te vitit, gushtit, është 16,3°C. Lageshtia relative e ajrit, si mesatare shumevjecare, është 75%, Lageshtia me e madhe verehet gjate muajve te dimrit, nentor-janar, me vlere mesatare shumevjecare 82-83%. Lageshtia me e vogel verehet ne muajt e veres, korrik dhe gusht, me vleren mesatare shumevjecare 65%. Zona klimatike, ne te cilen ndodhet pellgu ujembledhes, karakterizohet nga reshje atmosferike relativisht te paketa, nen mesataren e Republikes. Shtresa mesatare shumevjecare e reshjeve per pellgun ujembledhes, e llogaritur sipas metodes se mesatares aritmetike, është 840 mm ne vit.

Temperatura: Ne rrjedhjen e poshtme, temperaturat mesatare ndryshojne nga 6.8°C ne muajt e ftohte (janar) deri ne 23.8°C ne korrik. Temperatura mesatare vjetore është 15.1°C.


Temperaturat maksimale absolute ne serine shumevjecare arrihen ne korrik 43.2°C dhe ajo minimale absolute arrihet ne janar -12°C.

Muajt	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
Temp.mes	6.8	7.7	9.8	13.4	17.6	21.2	23	23.8	20.8	16.5	11.8	8.2
Max.abs.	20.5	25.4	26	32.5	36	39.3	43.2	39.9	38	32	28	23.4
Min.abs.	-12.5	-8.5	-7.2	-0.2	3.5	7.2	10	10.5	5	-1	-3.5	-8.2

Temperatura mesatare, maksimale absolute dhe minimale absolute ne rrjedhen e poshtme te lumit Kardhiq

**RAPORT PARAPRAK
VLERËSIM NDIKIMIT NË MJEDIS**

Me te dhenat e temperaturave mesatare shumevjecare ndertojme paraqitjen grafike te meposhteme.



Grafiku i ecurise brenda vitit e temperaturave mesatare te ajrit



Persa i takon shfaqjes se temperaturame nen 0 °C mund te themi se ato jane te pervitshme dhe vrojtohen duke filluar nga mesi i muajit tetor deri ne fund te prillit.

Reshjet atmosferike: Sasite me te medha te reshjeve bien ne periudhen e ftohte te vitit me rreth 62.5% te sasise vjetore dhe rreth 37.5% e tyre ne muajt e veres. Sasia vjetore e reshjeve eshte mesatarisht 1025mm.

Shperndarja e reshjeve gjate vitit si dhe maksimale 24 oreshe, maksimale absolute sipas muajve dhe numrin e diteve me reshje mbi 1mm jepen ne tabelen e meposhtme.

Muajt	I	II	III	IV	V	VI	VII	VII I	IX	X	XI	XII
Reshjet	107. 0	99. 2	91. 0	97. 7	92.0	56. 5	36. 1	42. 2	59. 7	95.8	183. 1	114. 4
Max.24h	58.6	57. 9	60. 0	64. 7	102. 2	70. 2	50. 4	59. 4	45. 4	135. 8	95.5	70.0
Nr.d.>1m m	8.9	9.1	9.2	8.4	8.2	5.3	3.5	3.9	5.3	7.2	9.8	9.2

RAPORT PARAPRAK
VLERËSIM NDIKIMIT NË MJEDIS



Sic shihet, vlera maksimale e reshjeve 24 oresh e regjistruar eshte 135.8mm ne muajin tetor. Kjo tregon per ndryshime jo shume te medha ne vleren e maksimumeve 24 oreshe te reshjeve te rregjistruar ne te gjithë zonen e pellgut te lumit Kardhiq.

Nderkaq numri mesatar i diteve me reshje >1mm eshte 87.9dite. Ne grafiket e mesiperme, ne te cilet jepen ecuria vjetore e reshjeve mesatare dhe numri i diteve me reshje >1mm, duket qarte ecuria e njejte e tyre, pra vlerat me te larta te tyre regjistrohen ne muajt e ftohte te vitit dhe ato me te uleta ne muajt e veres.

**RAPORT PARAPRAK
VLERËSIM NDIKIMIT NË MJEDIS**

Bora: Bora eshte fenomen i rralle ne kete zone, shfaqet ne dite te veçanta por nuk krijon shtrese bore.

Era: Era, e cila karakterizohet nga shpejtesia dhe frekuenca, ka drejtim dominant juglindjen ne 23% te rasteve. Shpejtesia mesatare vjetore 1.6m/s. Gjate vitit gjendja e qetesise se eres eshte deri ne 54%. Vlera maksimale e regjistruar ne serine e vrojtimeve eshte 34m/s.

3.2. Burimet ujore ne rajon

Hydrocentral i Kaparjelit ndodhet prane fshatit Kaparjel te rrethit te Gjirokastrës dhe shfrytëzon ujerat e perroit te Gugashit dege e lumit Kardhiqit. Vepra e marrjes se ujit ndodhet ne afersi te fshatit Kaparjel.

Rrjedhja Ujore: Te dhenat faktike per rrjedhjen ujore per perroin e Gugashit mungojne, madje nuk ekzistojne as matje te shkeputura te prurjeve te ujit ne kete perrua. Per kete arsye percaktimi i normes se rrjedhejs ujore dhe i rrjedhjes se vitit me 50% siguri eshte bere duke u mbeshtetur ne kushtet fiziko-gjeografike te pellgut ujembledhes (reshjeve atmosferike, relievit, bimesise etj.). Jane zbatuar disa metoda. Pervec dy metodave, qe perdoren zakonisht ne vendin tone, eshte perdorur dhe nje e trete, metode amerikane, e cila merr parasysh jo vetem ndikimin e madhesise se reshjeve vjetore dhe te temperatures se ajrit ne rrjedhjen ujore, por edhe ndikimin e regjimit vjetor te ketyre elementeve klimatike.

1. Metoda e analogjise.- Duke patur parasysh kushtet fiziko-gjeografike te pellgut ujembledhes, u pranua nje koeficient rrjedhjeje $a=0,35$ prej nga prurja me 50% siguri rezultoi 140 l/s.

2. Metoda e bilancit uhor.- Ekuacioni i bilancit uhor , per periudhen shumevjecare ka formen:

$$X_o=Y_o+Z_o \text{ prej nga } Y_o=X_o-Z_o$$

ku: X_o , Y_o dhe Z_o jane perkatesisht shtresat mesatare shumevjecare (normat) e reshjeve atmosferike, rrjedhjes ujore dhe avullimit te pergjitheshem nga siperfaqja e pellgut ujembledhes. Shtresa mesatare shumevjecare e avullimit te pergjitheshem eshte percaktuar sipas formulese se propozua nga Turk

$$Z_o= X_o/10,9+ X_o$$

**RAPORT PARAPRAK
VLERËSIM NDIKIMIT NË MJEDIS**

Ku : L- aftesia avulluese, qe eshte funksion i temperatures se ajrit ($L=f(t_0)$). Sipas kesaj metode, ne haze te te dhenave qe disponojme, rezulton nje prurje $Q_0=0$, 197 m³ Is.

3 .Metoda amerikane. - Bazohet ne relacionin univok si me poshte

$$Y/Ft = f(X/Ft)$$

ku: Y - shtresa e rrjedhjes vjetore, e llogaritur pa korriginimin perkates; X - shtresa vjetore e reshjeve atmosferike;

Ft - parameter, qe percaktohet ne funksion te temperatures vjetore te ajrit;

Duke pase parasysh, qe metoda e trete, ne kete rast, nuk dha rezultate te pranueshme, si dhe faktin, qe perroi i Gugashit e ka nje burim, ateheredo te pranojme rezultatin e perftuar sipas metodës se pare $Q_{50\%}=140$ Us. duke i here korriginimin per pranine e burirnit, dhe atehere prurja me 50% siguri ne aksin e vepres se marrjes se hidrocentralit te Kaparjelit rezultoi $Q_{50}= 210$ l/s.

Shperndarja brendavjetore e rrjedhjes: Percaktimi i shperndarjes brendavjetore te rrjedhjes se vitit me 50% siguri u be duke u bazuar ne metoden e analogjise. Per perroin e Gugashit kjo shperndarje ndikohet nga regjimi vjetor i rrjedhjes se perroit (kryesisht rrjedhje siperfaqsores) dhe nga regjimi vjetor i burirnit. Per kete arsye shperndarja brendavjetore e rrjedhjes se vitit me 50% siguri eshte perftuar nga superpozimi i te dy llojeve te shperndarjeve.

**RAPORT PARAPRAK
VLERËSIM NDIKIMIT NË MJEDIS**

4. IDENTIFIKIM I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS TË PROJEKTIT, PËRFSHIRË NDIKIMET NË BIODIVERSITET, UJË, TOKË DHE AJËR, PËRSHKRIM I SHKURTËR PËR SHKARKIMET E MUNDSHME NË MJEDIS, TË TILLA SI: UJËRA TË NDOTURA, GAZE DHE PLUHUR, ZHURMË, VIBRIME, SI DHE PËR PRODHIMIN E MBETJEVE SI DHE INFORMACIONI PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE TË IDENTIFIKUARA,

Veprimtaria që propozohet të kryhet ka përmasa të mëdha qoftë të karakterit të investimeve ashtu edhe të outputeve që do të japë gjatë shfrytëzimit të saj. Kjo është arsyeja që mbetet e një rëndësie të veçantë të analizohen ndikimet që do të ketë ajo që nga çasti i nisjes, pra e ndërtimit, dhe më tej ende, gjatë shfrytëzimit të saj deri ne transferimin e tij ne rrjetin kombetar. Ky kapitull gjithashtu do të paraqesë një analize te hollësishme te ndikimeve te mundshme duke specifikuar edhe masat zbutëse qe do te përdoren për te eliminuar apo për te minimizuar ndikimet ne mjedis. Kjo analize kryhet duke u bazuar ne projektin e konceptuar te diskutuar si me lart ne këtë raport. Ndikimet ne mjedis mund te ndodhin si gjate ndërtimit ashtu dhe gjate shfrytëzimit te ketij aktiviteti qe vleresohet si energji e rinovueshme dhe mund te grupohen si me poshtë:

- Kimike-Fizike te cilat lidhen me ndikimet mbi burimeve natyrore si edhe proceset e degradimit fizik te mjedisit vete.
- Biologjike-Ekologjike përfshirë burimet e energjive te rinovueshme, ruajtjen e biodiversitetit, ndikimin mbi jetën e gjalle te ndotjes se biosferës
- Sociologjike te lidhura me komunitetin apo edhe individët e veçante, ndikimin mbi trashëgiminë kulturore dhe progresin e supozuar.
- Ekonomike-Makroekonomike te cilat marrin parasysht ndikimet e përkohshme apo te përhershme shkaktuar për shkak te realizimit te projektit.

Kriteret e vlerësimit te ndikimit ne mjedis ndahen ne dy grupe kryesore:

- Kriteret me ndikim mbi procesin e vlerësimit, qofte edhe individualisht.
- Kriteret te cilët ndihmojnë ne vlerësimin e situatës por qe nuk kane ndikim ne proces

4.1. Vleresim i impakteve kryesore ne mjedis

